

**VENDIM**  
**Nr. 1134, datë 24.12.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKINË TIRANË DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë, në vlerën 1 608 555 182 (një miliard e gjashtëqind e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, përkatësisht, për:

a) ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr. 1 (Nr. 15), në vlerën 313 436 038 (treqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

b) ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr. 1 (Nr. 16), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

c) ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr. 1 (Nr. 18), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

ç) rikonstruksionin e godinave “Nr. 20–21; Nr. 22–23”, në RSU Nr. 1, në vlerën 456 772 100 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind) lekë pa TVSH;

d) ndërtimin e shkollës 9-vjeçare “Dritas”, në vlerën 215 496 468 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar, në vlerën 321 711 036 (treqind e njëzet e një milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit /rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**